



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr. 87, datë 30.03.2023

PËR

**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 103, DATË 29.09.2022 “PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË ANEKSIN NR. 1, BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 32, DATË 26.03.2021, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, L.17, RRUGA “LURA”, PALLATET NR.1&3, DHE RRUGA “AHMET DAKLI”, PALLATET NR. 15&23, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr.97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 103, datë 29.09.2022 “Për miratimin e një shtese në aneksin nr. 1, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 32, datë 26.03.2021, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për 4 Banesa Kolektive, L.17, rruga “Lura”, pallatet nr.1&3, dhe

rruga “Ahmet Dakli”, pallatet nr.15&23, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, i ndryshuar, Urdhërit nr. 135, datë 01.03.2021 të kryetares së bashkisë “Për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 të aplikantëve jofitues që nuk janë përzgjedhur nga programet e procesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5” i ndryshuar, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK  
VENDOSI:**



1. Miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 103, datë 29.09.2022 “Për miratimin e një shtese në aneksin nr. 1, bashkëlidhur vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 32, datë 26.03.2021, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për 4 Banesa Kolektive, L.17, rruga “Lura”, pallatet nr.1&3, dhe rruga “Ahmet Dakli”, pallatet nr. 15&23, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, i ndryshuar.
2. Miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 103, datë 29.09.2022, përsa i përket klasifikimit si përfitues të znj. Florenca Çoçoli në masën e strukturës 1+1 dhe z. Vlash Çuka në masën e strukturës 2+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 03.04.2023**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 232 / prot.  
11

Durrës, më 06.04 .2023

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

BASHKIA DURRËS  
06 04 23 No. 2560/10  
PROT

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.87 datë 30.03.2023 “Për miratimin ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.103, datë 29.09.2022 “Për miratimin e një shtese në aneksin nr. 1, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 32, datë 26.03.2021, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për 4 banesa kolektive, 1.17, rruga “Lura”, pallatet nr. 1&3, dhe rruga “Ahmet Dakli”, pallatet nr. 15&23, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, i ndryshuar.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

